




MODELI 3D I QYTETIT TË MALIQIT
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV

Finalizohet aplikacioni digjital “Monitorimi i serrave bujqësore 2023 - 2025”, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

ASIG ka përfunduar me sukses realizimin dhe publikimin e aplikacionit tematik digjital interaktiv “Monitorimi i serrave bujqësore 2023–2025”, i cili ofron një pasqyrë të përditësuar mbi shpërndarjen gjeografike, sipërfaqen dhe numrin e serrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, të organizuara sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Përmes paraqitjeve grafike dhe analizave vizuale, aplikacioni mundëson identifikimin e bashkive me përqendrimin më të lartë të serrave, duke iu shërbyer institucioneve publike për ndjekjen dhe analizimin e këtij aktiviteti bujqësor.



Dashboard-i Interaktiv: “Monitorimi i serrave bujqësore 2023 - 2025”

Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare, ASIG ka përdorur teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360° për të realizuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar fotografimin e rrugëve urbane të qytetit të Shijakut dhe njësisë administrative Sukth, me gjatësi prej 37 km. Gjithashtu, janë fotografuar dhe rrugët urbane të qytetit të Maliqit, me një mbulim prej 35.2 km dhe rrugët urbane të qytetit të Bilishtit me një mbulim prej 27 km pamje 360°. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane – Shijak



Rrugë Urbane – Bilisht

Rilevim me teknologjinë UAV - Zonat Maliq dhe Voskopojë

Në funksion të përmirësimit të planifikimit urban dhe administrimit të territorit, ASIG ka kryer rlevime fotogrametrike të zonave urbane të qytetit të Maliqit dhe Njesisë Administrative Voskopojë me teknologjinë UAV (Unmanned Aerial Vehicle).


Rilevimi për Bashkinë Maliq mbulon një sipërfaqe prej 7.5 km², ndërsa për Njësine Administrative Voskopojë një sipërfaqe prej 4.5 km², me rezolucion 4 cm, gjë e cila garanton cilësi të lartë dhe detaje të imta për analizat gjeohapësinore në mjedisin urban.

Në vijim të procesit, u krye edhe një mision fotografimi me metodën "oblique", e cila mundëson imazhe me kënde të ndryshme, duke ofruar pamje reale dhe detaje të sakta të terrenit dhe objekteve.


Produktet e ofruara përfshijnë:

- Ortofoto;
- DSM (Modeli Digjital i Sipërfaqes);
- DTM (Modeli Digjital i Terrenit);
- Izoipse.

Këto produkte krijojnë një infrastrukturë të besueshme referimi për projektet zhvillimore në nivel lokal dhe kombëtar



Ortofoto, DSM – Maliq



Izoipse, DTM – Voskopojë


Zgjerimi i Hartës Bazë - Zona Koljakaj në Shkodër

ASIG në cilësinë e Autoritetit Publik Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Koljakaj, në Bashkinë Shkodër.

Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 37 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



Përditësimi i Shtresës “Rrjeti Shtetëror Gravimetrik i Republikës së Shqipërisë”



ASIG ka përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën “Rrjeti Shtetëror Gravimetrik i Republikës së Shqipërisë”, e cila përfshin informacion gjeohapësinor për:

1. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit Zero (3 pika);
2. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Parë (42 pika);
3. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Dytë (338 pika);
4. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Tretë (1072 pika).

Përditësimi përfshin shtimin e 300 pikave gravimetrike të rendit të tretë, të matura gjatë vitit 2025, në pjesën veriore të vendit, duke filluar nga segmenti Milot–Kukës dhe deri në kufijtë shtetërorë me Malin e Zi dhe Kosovën.

Zhvillohet takimi informues mbi nisjen e projektit të fotografimit ajror në Shqipëri

Më datë 7 prill 2026, ASIG dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) zhvilluan një takim prezantues me përfaqësuesit e kompanisë turke Mescioğlu, në kuadër të nisjes së projektit për realizimin e fotografimit ajror të ri në Republikën e Shqipërisë. Gjatë takimit, palët diskutuan mbi Planin e Implementimit të Projektit, si faza e parë e parashikuar në kushtet e kontratës, duke shënuar nisjen e këtij projekti të rëndësishëm për përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore në vend.

Ky bashkëpunim synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e infrastrukturës gjeohapësinore në Shqipëri.



ASIG organizon aktivitetin “Gratë në Teknologjitë Gjeohapësinore - Histori Suksesit”

Më 2 prill 2026, në ambientet e Europe House, Tiranë, ASIG organizoi aktivitetin “Gratë në Teknologjitë Gjeohapësinore – Histori Suksesit”, në kuadër të nismave për promovimin e rolit dhe kontributit të grave në fushën e teknologjive gjeohapësinore.

Aktiviteti mbledhi së bashku përfaqësuese nga institucionet publike, akademia dhe sektori privat, të cilat ndanë përvojat e tyre profesionale, sfidat e hasura gjatë rrugëtimit të tyre, si dhe perspektivat mbi zhvillimin e kësaj fushe në Shqipëri. Përmes këtij bashkëbisedimi dolën në pah jo vetëm arritjet individuale dhe institucionale, por edhe rëndësia e përfshirjes së grave në sektorë të lidhur ngushtë me teknologjinë, inovacionin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore.

ASIG mbetet i angazhuar për të mbështetur nisma që promovojnë zhvillimin e kapaciteteve, fuqizimin profesional dhe krijimin e mundësive të reja për përfshirjen e grave në fusha me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit



ASIG organizon konkursin “Mapathon në kuadër të Ditës së Tokës 2026”



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, ASIG organizoi më 22 prill 2026, në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës, aktivitetin “Mapathon”, me pjesëmarrjen e nxënësve të disa prej shkollave të mesme të qytetit të Tiranës. Aktiviteti synoi të afrojë të rinjtë me përdorimin e hartave, të dhënave gjeohapësinore dhe Gjeoportalit Kombëtar, në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e Tokës. Gjatë konkursit, pjesëmarrësit punuan në ekipe për hartimin e hartave tematike, duke zbatuar njohuri praktike mbi elementet e hartës dhe interpretimin e informacionit të përpunuar. Në përfundim, punimet u vlerësuan nga juria sipas kriterëve të përcaktuara, ku Gjymnazi “Sinan Tafaj” u rendit i pari.

Aktiviteti shërbeu si një mundësi konkrete për të nxitur interesin e të rinjve ndaj teknologjive gjeohapësinore dhe përdorimit të tyre për kuptimin e territorit, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Me qëllim rritjen e kapaciteteve në menaxhimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, ASIG zhvilloi më datë 7–8 prill 2026 një trajnim dyditor me stafet teknike të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës–Kanalizime Sarandë. Aktiviteti u fokusua në mbledhjen, strukturimin dhe publikimin e të dhënave që lidhen me rrjetin e ujësjiellës-kanalizimeve, si dhe përmirësimin e proceseve të administrimit të tyre sipas standardeve kombëtare të gjeoinformacionit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me kërkesat e standardit teknik të gjeoinformacionit “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, si edhe me procedurat për përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar për administrimin, përditësimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapësinore.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

CDSE publikon studimin e parë shkencor për të dhënat e vëzhgimit të Tokës

Ekosistemi i të Dhënave Hapësinore Copernicus (Copernicus Data Space Ecosystem – CDSE) ka publikuar studimin e parë shkencor në revistën Scientific Data të Nature, i cili paraqet rolin e platformës në ruajtjen, përpunimin cloud dhe standardizimin e aksesit në të dhënat e vëzhgimit të Tokës. Studimi përmbledh të dhënat dhe API-të e disponueshme në CDSE, si dhe mënyrën se si kjo platformë mbështet aplikimet e inteligjencës artificiale. Ky publikim ofron një referencë të citueshme për CDSE dhe nënvizon rëndësinë e përpunimit cloud për përdorimin më të gjerë të të dhënave satelitore nga komuniteti shkencor dhe përdoruesit institucionalë.

ESA dhe EDA nënshkruajnë marrëveshjen për forcimin e aftësive evropiane në vëzhgimin e Tokës

Agjencia Evropiane Hapësinore (European Space Agency – ESA) dhe Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (European Defence Agency – EDA) kanë nënshkruar një marrëveshje për identifikimin e mangësive strategjike dhe teknologjike në aftësitë evropiane të vëzhgimit të Tokës, si dhe për hartimin e një plani afatgjatë në mbështetje të sigurisë dhe mbrojtjes. Studimi i përbashkët do të vlerësojë nevojat aktuale dhe të ardhshme për vëzhgimin e Tokës, do të identifikojë mangësitë kritike dhe do të përcaktojë prioritetet e zhvillimit teknologjik deri në vitin 2040 dhe më tej. Kjo nismë synon të forcojë kapacitetet evropiane për përdorimin e të dhënave hapësinore në një kontekst gjeopolitik gjithnjë e më kompleks.

AKTIVITETE NË VIJIM

2026 Geo Symposium/ GEO-21 Plenary

Nga 26 - 28 maj 2026, në Gjenevë, të Zvicrës, do të zhvillohet GEO Symposium dhe GEO-21 Plenary, një aktivitet ndërkombëtar i fokusuar në përdorimin e “Earth Intelligence” për një të ardhme më të qëndrueshme. Ky event do të mbledhë aktorë qeveritarë, agjenci hapësinore, organizata kërkimore dhe sektorin privat për të diskutuar rolin e të dhënave gjeohapësinore në adresimin e sfidave globale.

26 - 28 Maj 2026

GeoAI 2026

Nga data 3 – 6 qershor 2026, në Ghent, të Belgjikës, do të zhvillohet Konferenca e Parë Ndërkombëtare mbi Inteligjencën Artificiale Gjeohapësinore (GeoAI 2026). Aktiviteti mbledh studiues dhe profesionistë nga fusha të ndryshme për të diskutuar zhvillimet më të fundit në integrimin e inteligjencës artificiale me të dhënat gjeohapësinore, si dhe aplikimet e saj në analizë, hartografi, vendimmarrje dhe bashkëpunim ndërmjet njeriut dhe IA.

3 - 6 Qershor 2026

AGILE 2026

Nga 16 – 19 qershor 2026, në Tartu, të Estonisë, do të zhvillohet Konferenca e 29-të e Shoqatës Evropiane të Laboratorëve të Informacionit Gjeografik, një ngjarje ndërkombëtare dedikuar informacionit gjeohapësinor. Konferenca fokusohet në “Smart Data”, duke theksuar shndërrimin e të dhënave gjeohapësinore në njohuri të përdorshme për vendimmarrje dhe zgjidhje problemesh reale, përmes kërkimeve dhe aplikimeve të reja.

16 - 19 Qershor 2026

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al